

VENDIM
Nr. 171, datë 19.4.1997

PËR FUNKSIONET E SEKRETARËVE TË SHTETIT NË QEVERINË E PAJTIMIT
KOMBËTAR

Mbështetur në konsensusin e partive politike nënshkruese të marrëveshjes së 9 marsit 1997, si edhe për të mundësuar realizimin e funksioneve të sekretarëve të shtetit në ministrinë ku ata janë emëruar, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sekretarët e shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes ushtrojnë funksione koordinuese dhe drejtuese të politikës në ministrinë përkatëse.

Sekretari i shtetit drejton veprimtarinë e përditshme të sektorëve të veçantë të ministrisë, të caktuar nga ministri përkatës në bashkëpunim me sekretarin e shtetit.

2. Sekretarët e shtetit nënshkruajnë, së bashku me ministrat përkatës, projektet e akteve dhe relacionet e tyre që ia paraqiten për shqyrtim Këshillit të Ministrave, si dhe aktet me karakter individual a normativ që nxirren nga ministrinë ku ata janë emëruar.

Projektet e akteve të mësipërme i dërgohen paraprakisht për nënshkrim sekretarit të shtetit, i cili, përpara nënshkrimit, ka të drejtë të kërkojë sqarime plotësuese nga punonjësit e ministrisë që janë marrë me përgatitjen e tyre.

Pas nënshkrimit të sekretarit të shtetit, këto projekte i kalojnë për nënshkrim ministrit përkatës.

3. Të gjitha aktet individuale dhe normative që nxirren nga sekretarët e shtetit për sektorët që ata drejtojnë, nënshkruhen edhe nga ministrat përkatës.

4. Problemet që lindin lidhur me vërejtjet ose sugjerimet për ndryshimin dhe përmirësimin e projekteve të akteve ndërmjet ministrave dhe sekretarëve të shtetit, zgjidhen me konsensus ndërmjet tyre. Nëse ky konsensus nuk arrihet, atëherë mosmarrëveshja shqyrtohet nga Këshilli i Ministrave.

5. Sekretarët e shtetit kanë të drejtë të thërrasin për ndihmë, konsulencë ose informacion, nëpunës a organe të ministrive përkatëse që nuk i përkasin sektorit që ata drejtojnë. Në këtë rast sekretari i shtetit nuk ushtron ndaj këtyre nëpunësve a organeve pushtet hierarkik ose organizativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij deri në mbarimin e veprimtarisë së Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino